



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 50/2012
Prishtinë, më 21.02. 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha –OSBE, Ukë Gashi - ZRPK; Ardian Kryeziu dhe Gëzim Kolgeci – USAID/BEEP dhe Florije Mehmeti –KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, dhe Brikena Hoxha- konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.02.2012;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit Nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike;
4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit Nr. 04/L-94 për Shërbimet e shoqërisë informatike;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.02.2012

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 14.02.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit Nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike

Kryetari – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi raportuesin z. Deshishku për raportim në lidhje me këtë projektligj.

Hashim Deshishku – Në emër të grupit punues paraqiti raportin me 21 propozim-amendamente, të cilat kanë dalë pas mbledhjes së grupit punues më 13.02.2012, dhe hapi debat.

Lutfi Zharku – Propozoi që neni 7 të fshihet, sepse është e qartë ajo çfarë përmban neni 14.2 i ligjit bazik.

Visar Ymeri – E përkrahu z. Zharku dhe kërkoi po ashtu që të votohet amendament 9, por në përmbajtje “të fshihet neni 7 i projektligjit”.

Kryetari – Tha së më propozimin e ministrisë shihet qartë se qëllimi ka qenë t'i iket burokracisë.

Ramiz Kelmendi – Tha se e përkrah propozimin e ministrisë, sepse më këtë ndryshim po i ndihmohet bizneseve në lehtësira administrative.

Hashim Deshishku – Propozoi që të votohet Amendamenti 7 më përmbajtjen e dhënë në raport.

Komisioni më 5 vota Për dhe 3 Kundër miratoi propozimin e grupit punues.

Visar Ymeri – Propozoi që në nenin 8, fjala e propozuar “mirëpritje” të zëvendësohet me ‘mirëpritur’.

Komisioni përkrahu propozimin e z. Ymeri.

Biserka Kostić – tha se në lidhje me Amendamentin 21 që fshinë Nenin 23, nuk kemi marr vendim, por jemi dakorduar që të vendos Komisioni në mbledhje.

Propozimi i MTI- së në lidhje me “Organizatën Nacionale Turistike të Kosovës”

Lutfi Zharku – Theksoi se ky propozim sikurse që është përfshirë edhe si nen 23 është i panevojshëm. Për shkak se kemi Departamentin e Turizmit të MTI- së. Është i paqartë dhe nuk dihet statusi i kësaj organizate së çfarë është dhe nëpunësit, a janë shërbyes civilë apo çka? Dhe, arsyetimi se e kanë vendet e rajonit nuk është arsye bazë që të kemi edhe ne. Zoti Zharku, tha se nuk pajtohet as më propozimin në nenin 16, ku thuhet se ‘kategorizimi i objekteve hoteliere është jo i obliguar’.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se është e paqartë çka përmban ky propozim, sepse nuk dihet a është një OJQ ose funksionon brenda institucioneve Organizata Nacionale Turistike.

Hashim Deshishku – Në fund paraqiti vërejtje në lidhje me sjelljen e përfaqësuesit të MTI-së, z. Hysen Sogojeva, ku grup punues, ka përdorë fjalë banale gjatë komunikimit dhe ka fyer deputetin personalisht.

Kryetari – Kërkoj që për këto dilema të thërrasim në një mbledhje të rregullt ministren e MTI-së ta sqarojë çështjen e “Organizatës Nacionale Turistike” dhe çështjen e “kategorizimit”.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

1. Miratohen propozim-amendamentet e grupit punues për Projektligjin Nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike;
2. Të ftohet ministrja e MTI-së në raportim në Komision, për arsyetimin e Propozimit në lidhje me “Organizatën Nacionale Turistike të Kosovës” dhe çështjen e “kategorizimit të objekteve hoteliere”.

4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit Nr. 04/L-94 për Shërbimet e shoqërisë informatike;

Kryetari – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës, kemi raportuesen zonj. Sahatqija për raportim në lidhje me këtë projektligj.

Teuta Sahatqija – Theksoi se në mbledhjet e mbajtura më 09 dhe 15.02.2012 kemi hartuar 36 propozim-amendamente dhe hapi debat.

Visar Ymeri – Propozoi që të fshihet nënparagrafi 1.29, neni 2, “Personi juridik”, sepse s’ka nevojë të potencohet me këtë ligj; te amendamenti 6 të fshihet “nëse ato nuk kthehen prapa”;

Propozimet u përkrahen nga Komisioni.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamenteve të Projektligjit Nr. 04/L-94 për Shërbimet e shoqërisë informatike për mbledhjen e radhës.

5. Të ndryshme

a) Kërkesa e sindikatës së KEK-ut

Kryetari – E njoftoi Komisionin se kemi marrë një kërkesë nga ana e dy sindikatave të KEK-ut për një takim me ta.

b) Vizitat te agjencitë e pavarura

Kryetari – E njoftoi Komisionin se nesër më 22.02.2012 do të vizitohet Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Zenun Pajaziti
Kryetar i Komisionit**